

BULETINI I LAJMEVE TË SIGURISË KIBERNETIKE

Dhjetor 2020



CyberSec 2.0

AKCESK, në cilësinë e Autoritetit përgjegjës për sigurinë kibernetike në Republikën e Shqipërisë organizoi trajnimin online *"CyberSec 2.0"*. Aktiviteti synoi rritjen e kapaciteteve dhe thellimin e njohurive në fushën e sigurisë kibernetike të operatorëve të infrastrukturave kritike të informacionit, si dhe promovimin e bashkëpunimit për ofrimin e trajnimeve specifike mbi *"MDFIR Certified DFIR Specialist certification"* dhe *"MTIA - Certified Threat Intelligence Analyst"* për anëtarët e CSIRTs sektorial në bashkëpunim me Mosse Cyber Security Institute.

Deklaratë e Përbashkët e FBI, CISA, ODNI dhe NSA për APT

Në rrjetet qeveritare dhe jo-qeveritare në SHBA së fundi ka ndodhur një sulm i iniciuar nga një grup APT, i cili mendohet të ketë origjinë ruse. Këshilli i Sigurimit Kombëtar ka ngritur task forcën e emërtuar Grupi i Përbashkët i Koordinimit Kibernetik (UCG), të përbërë nga Byroja Federale e Hetimit (FBI), Agjencia e Sigurisë së Infrastrukturave dhe Sigurisë Kibernetike (CISA), Zyra e Drejtorisë së Inteligjencës Kombëtare (ODNI) me mbështetjen e Agjencisë së Sigurimit Kombëtar (NSA), e cila ka si qëllim të hetojë incidentin kibernetik të ndodhur së fundmi në rrjetet qeveritare. Qëllimi i këtyre sulmeve mendohet të jetë mbledhja e informacioneve dhe të dhënave, ndërkohë që po punohet për të kuptuar më qartë motivin e kësaj fushate. UCG parashikon se numri i personave të kompromentuar nga kyaktivitet është i ulët dhe arrin në 18,000 klientë të produktit *"Solar Winds Orion"*, të cilët i përkasin sektorit publik ose privat. FBI, si agjencia kryesore për përgjigjen ndaj kërcënimeve, aktualisht e ka përqendruar hetimin në katër linja kritike: identifikimin e viktimave, mbledhjen dhe analizimin e provave për të përcaktuar hapat e mëtejshëm dhe vendosjen në dijeni të Qeverisë dhe partnerëve të sektorit privat për rezultatet. CISA është përqendruar në shkëmbimin e informacionit në mënyrë të shpejt midis Qeverisë dhe sektorit privat. Gjithashtu, ka krijuar një mjet falas për zbulimin e veprimtarisë potencialisht të dëmshme në lidhje me këtë incident. ODNI ka koordinuar Komunitetin e Inteligjencës për të siguruar që UCG ka inteligjencën më të përparuar për t'u përgjigjur ndaj incidenteve që ndodhin në Qeverinë e Shteteve të Bashkuara. Së fundi, NSA mbështet UCG duke ofruar inteligjencë, ekspertizë të sigurisë kibernetike dhe udhëzime vepruese për partnerët e UCG. Angazhimi i NSA me UCG dhe partnerët e industrisë është përqendruar në vlerësimin e shkallës dhe qëllimit të incidentit, si dhe sigurimin e masave teknike të mitigimit.



Polonia & Lituania, pre e një dezinformimi kibernetik



Disa zyrtarë në Poloni dhe Lituani zbuluan se të dy vendet kanë qenë shenjestër e një fushate të sofistikuar të dezinformimit kibernetik. Fushata konsistonte në vjedhjen e 22 faqeve të cilat i përkisnin komunave rajonale Lituaneze. Këto faqe u shfrytëzuan për botimin e një informacioni të rremë. Lajmi i trilluar ishte "Shërbimi Shtetëror i Ruajtjes së Kufirit të Lituanisë (VSAT) ndaloi një diplomat polak i cili mbante lëndë plasëse dhe materiale ekstremiste.

Sipas Stanislaw Zaryn, zëdhënësi i kreut të Shërbimeve të Sigurisë së Polonisë, tiparet e sulmit dhe qëllimi i tij ishte të ndikonte negativisht në marrëdhënien Poloni - Lituani. Kjo tregon se Rusia mund të jetë përgjegjëse për fillimin e sulmit.